

VENDIM
Nr.53, datë 23.11.2004

**PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR PRODHIMIN DHE SHPËRNDARJEN E ENERGJISË
ELEKTRIKE SHOQËRISË KESH SHA**

Në mbështetje të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të nenit 13 pika 1, nenit 15 të ligjit nr.7638 datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” me të gjitha ndryshimet përkatëse, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.797, datë 4.12.2003 “Për krijimin e shoqërisë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a. Tiranë”, pika 3 dhe pika 4 vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.27, datë 30.5.2004 “Rregullorja për procedurat e licencimit”, urdhrit të Ministrit të Ekonomisë nr.63, datë 18.3.2004 “Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. “KESH” Tiranë dhe krijimin e shoqërisë së re “Operatori i Sistemit të Transmetimit”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 23.11.2004, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga “KESH” sh.a. për marrje licence për aktivitetin e prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, konstatoi se nga tërësia e kërkesave të parashikuara në aktet e mësipërme nuk janë plotësuar kushtet si më poshtë:

I. Në zbatim të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” neni 33 pika 1, ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, me të gjitha ndryshimet përkatëse, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.797, datë 4.12.2003 “Për krijimin e shoqërisë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a. Tiranë pika 3 dhe urdhrit të Ministrit të Ekonomisë nr.63, datë 18.3.2004 “Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. “KESH”, Tiranë” dhe krijimin e shoqërisë së re “Operatori i Sistemit të Transmetimit” pika 2 dhe pika 3:

i) ndarjen e plotë të llogarive financiare,
ii) raportin e ekspertit kontabël, si dhe transferimin e plotë të aseteve të nevojshme për realizimin e aktivitetit të transmetimit nga “KESH” sh.a. për “OST” sh.a.

II. Në zbatim të rregullores për procedurat e licencimit neni 10 germa c, pika 3, pika 5 dhe neni 11 pika 1 paragrafi 8, paragrafi 9, paragrafi 10 , dhe neni 11 pika 3:

i) lidhjen e një kontrate sigurimi me një nga shoqëritë e sigurimit për aktivitetin e prodhimit dhe të shpërndarjes;

ii) vërtetimin për mbështetje financiare nga institucionet financiare brenda dhe jashtë vendit;

iii) vlerësimin paraprak të ndikimit në mjedis të aseteve prodhuese, në nivel lokal dhe kombëtar;

iv) vlerësimin e përafërt të investimeve të kërkuara;

v) strukturën e kapitalit që do të përdoret për investime dhe burimet e financimit të shprehura në vlerë monetare;

vi) marrëveshjen paraprake për sigurinë e furnizimit me lëndë djegëse të TEC-it Fier;

vii) planin e investimeve për zgjerimin e rrjetit shpërndarës për vitin 2005;

viii) planin e investimeve për përmirësimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit shpërndarës për vitin 2005.

Në bazë të konstatimeve të përmendura më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

I. Dhënie e licencës shoqërisë “KESH” sh.a. për:

i) prodhimin e energjisë elektrike me një afat kohor deri në datën 31.12.2005;

ii) shpërndarjen e energjise elektrike me një afat kohor deri në datën 31.12.2005.

II. Kjo licencë jepet me kusht. Shoqëria KESH sh.a, brenda afatit 31.12.2005, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

i) Ndarjen e plotë të llogarive financiare në përputhje me ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” neni 33 pika 1;

ii) Raportin e ekspertit kontabël në zbatim të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Per shoqëritë tregtare”, me të gjitha ndryshimet përkatëse, neni 251, 256 dhe urdhrit të Ministrit të Ekonomisë nr.63 datë 18.3.2004 “Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a.“KESH” Tiranë” dhe krijimin e shoqërisë së re “Operatori i Sistemit të Transmetimit” pika 3;

iii) Transferimin e plotë të aseteve të nevojshme për realizimin e aktivitetit të transmetimit nga

“KESH” sh.a. për “OST” sh.a. në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.797, datë 4.12.2003 “Për krijimin e shoqërisë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a. Tiranë” pika 4, urdhrit të Ministrit të Ekonomisë nr.63, datë 18.3.2004 “Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. “KESH” Tiranë” dhe krijimin e shoqërisë së re “Operatori i Sistemit të Transmetimit” pika 2;

iv) Lidhjen e një kontrate sigurimi me një nga shoqëritë e sigurimit për aktivitetin e prodhimit dhe shpërndarjes në përputhje me “Rregulloren për procedurat e licencimit” neni 10 germa c pika 3;

v) Vërtetimin për mbështetje financiare nga institucionet financiare brenda dhe jashtë vendit në përputhje me “Rregulloren për procedurat e licencimit” neni 10 germa c pika 5;

vi) Vlerësimin paraprak të ndikimit në mjedis në nivel lokal dhe kombëtar të aseteve prodhuese në përputhje me “Rregulloren për procedurat e licencimit” neni 11 pika 1;

vii) Vlerësimin e përafërt të investimeve të kërkuara në përputhje me “Rregulloren për procedurat e licencimit” neni 11 pika 1;

viii) Strukturën e kapitalit që do të përdoret për investime dhe burimet e financimit të shprehura në vlerë monetare në përputhje me “Rregulloren për procedurat e licencimit” neni 11 pika 1;

ix) Marrëveshjen paraprake për sigurinë e furnizimit me lëndë djegëse të TEC-it, Fier në përputhje me “Rregulloren për procedurat e licencimit” neni 11 pika 1;

x) Planin e investimeve për zgjerimin e rrjetit shpërndarës për vitin 2005 në përputhje me “Rregulloren për procedurat e licencimit” neni 11 pika 3;

xi) Planin e investimeve për përmirësimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit shpërndarës për vitin 2005 në përputhje me “Rregulloren për procedurat e licencimit” neni 11 pika 3;

xii) Pasqyrimin në statutin e shoqërisë “KESH” sh.a. të ndryshimeve në kapitalin themeltar në përputhje me urdhrin e Ministrit të Ekonomisë nr.63 datë 18.3.2004 “Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. “KESH”, Tiranë” dhe krijimin e shoqërisë së re “Operatori i Sistemit të Transmetimit”;

xiii) Përcaktimin e faktorëve të humbjeve të energjisë në rrjetin shpërndarës për çdo nivel tensioni në përputhje me aneksin B të licencës për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema